

Evjeni Sinojmeri



GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË APELIT
TIRANË


Deklaratat e analizuara:

16 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017

Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite




Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2017 është rritur 13.2 herë

+ 3,266,490 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete
në Bankë




Likuiditete
në Cash



Pasuritë e
Luajtshme



Pasuritë e
Paluajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga nga funksioni	19,618,293	23.7%
Paga e familjarëve	50,233,525	60.6%
Dhurata ne Cash	1,728,450	2.1%
Mesimdhënia	399,300	0.5%
Te ardhura nga shitja e pasurive te paluajtshme	3,900,000	4.7%
Te ardhura te tjera	6,969,845	8.4%
Total	82,849,413	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

1 Me probleme
13 Pa Probleme

Subjekti Evjeni Sinojmeri, me të dhënat e deklaruara në vitin 2011 rezultoi me burime të pamjaftueshme financiare lidhur me shtesën e aseteve në shumën 1,706,889 lekë. Në vitin 2005, subjekti deklaroi se ka shitur një truall me sip. 165 m² dhe punime të kryera mbi të në lagjen "18 Shtatori", Gjirokastër në shumën 3,900,000 lekë - por nuk ka të dhëna sa është çmimi i krijimit të kësaj pasurie apo investimi i kryer. Në vitin 2006 deklarohet blerje e dy apartamenteve me burim pakësimin e likuiditeteve cash deklaruar më parë dhe huamarrje nga babai në shumën 6,000 euro. Në vitin 2008 deklarohet shtim pasurie në shumën 3,500,000 lekë me burim dhurimin nga vjehri prej shumës së përfituar prej tij nga kompensimi si ish-pronar. Në vitin 2014, djali i subjektit deklaroi dhurata nga gjyshërit në shumën 15,000 USD me rastin e largimit të tij në SHBA. Nga viti 2014 e në vazhdim, djali i subjektit me bashkëshorten e tij deklaroi si persona të lidhur të ardhurat dhe ndryshimin e pasurisë së krijuar nga puna në SHBA, duke rritur ndjeshëm të ardhurat totale familjare. Por në mungesë të shpenzimeve të jetesës është e pamundur të arrihet në konkluzione të sakta lidhur me sa është deklaruar.